



This project is funded by
the European Union



50
YEARS

Empowered lives. Resilient nations.

ÇËSHTJET GJINORE DHE KONTROLLI I ARMËVE TË VOGLA DHE TË LEHTA (SALW) Kuadri ligjor dhe i politikave në Evropën Juglindore

Hyrja

Politikat për kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta kanë si qëllim që të rrisin sigurinë e përgjithshme të qytetarëve nëpërmjet planifikimit dhe zbatimit të masave të ndryshme për të frenuar përhapjen dhe keqpërdorimin e tyre. Ndërkohë që disa shqetësime për sigurinë janë të përbashkëta për të gjithë shoqërinë, ekzistojnë shqetësime të tjera që ndikojnë në mënyra të ndryshme te persona të ndryshëm në varësi të seksit, gjinisë, moshës, etnisë, etj.

Një sërë studimesh, numri i të cilëve është në rritje, kanë kon-

tribuar ndjeshëm në rritjen e vizibilitetit të lidhjeve ndërmjet gjinisë dhe SALW¹-ve dhe ato kanë treguar qartë se përdorimi, keqpërdorimi dhe efektet e SALW-ve janë shumë të lidhura me aspektin gjinor dhe kanë ndikime të ndryshme te gratë dhe te burrat (Farr and Gebre-Wold 2002, Schroeder et al. 2005, Farr et al. 2009, Alvazzi del Frate 2011, Bastick and Valasek, 2014).

Për të rritur efikasitetin e politikave për kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta dhe për të siguruar që zbatimi i tyre të përmirësojë sigurinë si për gratë, edhe për burrat, këto këndvështrime të ndryshme duhet të bëhen të dukshme, të integrohen në politikat për kontrollin e SALW-ve dhe të trajtohen siç duhet.

1 SALW është një shkurtime për armët e vogla dhe të lehta.

GJINIA

Gjinia i referohet roleve dhe sjelljeve sociale, të cilat në një shoqëri kuptohen si të përshtatshme për gratë dhe burrat. Ajo ka të bëjë me ndryshimet shoqërore (jo ato biologjike) ndërmjet grave dhe burrave, të cilat ndryshojnë me kalimin e kohës.

Gjinia nuk i referohet vetëm grave, por i referohet grave dhe burrave, vajzave dhe djemve dhe marrëdhënies ndërmjet tyre.

Gjinia përcakton atë çfarë pritet, çfarë lejohet dhe vlerësohet për gratë dhe burrat në një kontekst të caktuar. Ajo përcakton gjithashtu veprimtaritë që ndërmerren ndërmjet grave dhe burrave, qasjen në burime dhe kontrollin mbi to, si dhe mundësitë për vendimarrje.

(Burimi: UN Women, OSAGI Gender Mainstreaming Concept and Definitions, 2001)




Këndvështrimi gjinor luan një rol të rëndësishëm në dhënien e formës dhe në kuptimin e aspekteve të ndryshme të SALW, si p.sh. (Cukier and Cairns 2009, f. 19):

Zotërimi dhe qasja

Burrat përbëjnë shumicën dërrmuese të zotëruesve të armëve të zjarrit – 98% në Mal të Zi, 95% në Serbi, 96% në Moldavi, 96% në nivel mbarë evropian (SAS 2014b) dhe ata dominojnë edhe në profesionet që kanë qasje të lehtë në armët e zjarrit (polici, ushtri, kompani private të sigurisë), edhe në veprimtaritë që lidhen me armët e zjarrit, si gjuetia.

Figura 1: Gjinia dhe qëndrimet ndaj armëve të zjarrit



Efektet

Burrat përbëjnë shumicën absolute në cilësinë e autorëve dhe të viktimave të incidenteve me armë zjarri. Gratë janë kryesisht viktimat dhe shumë rrallë autore të veprave me armë zjarri. Duke pasur parasysh përqindjen shumë të ulët që zënë gratë si zotëruese të armëve të zjarrit dhe autore veprash në incidentet që lidhen me armët e zjarrit, ato përjetojnë një shpeshësi shumë të lartë viktimizimi krahasuar me burrat (Cukier 2002).

Dhuna në familje

Ndërkohë që burrat rrezikohen më tepër nga keqpërdorimi i armëve të zjarrit nga të njohurit e tyre jo intimë ose nga persona që ata mund të mos i njohin, **gratë rrezikohen më tepër në kontekstin familjar nga partnerët e tyre intimë** - prania e armëve në shtëpi rrit në mënyrë dramatike rreziqet dhe gjasat e një rezultati vdekjeprurës në incidentet e dhunës në familje.

Burrëria, normat kulturore, kultura e armëve

Nëpërmjet përdorimit dhe keqpërdorimit të tyre, **armët e vogla lidhen ngushtë me shprehjet specifike të burrërisë në shoqëri**, d.m.th. me role, sjellje dhe pritshmëri të caktuara që i atribuohen burrave dhe që nxisin sjellje të rrezikshme nga burrat.


Qëndrimet

Gratë dhe burrat shpesh kanë qëndrime të ndryshme ndaj armëve dhe gratë, më shpesh se burrat, e perceptojnë praninë e armëve të zjarrit si rrezik për sigurinë e tyre. Për rrjedhojë, ato mbështesin një kontroll më të rreptë të SALW.

Hartimi i politikave

Përfaqësimi i ekuilibruar i grave dhe burrave është kusht paraprak për të përfshirë një shumëllojshmëri këndvështrimesh dhe shqetësimesh gjinore në ciklin e hartimit të politikave. Megjithatë, sfidat për përfaqësimin e duhur dhe kuptimplotë të grave në hartimin dhe zbatimin e politikave për kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta vazhdojnë të jenë të shumta. Rrallë ndodh që gratë të kenë pozicione vendimmarrëse në organe që përgatisin politika për SALW-të dhe proceset e kontrollit të armëve vazhdojnë të dominohen nga meshkujt (Cukier 2009).

Figura 2: Autorët dhe viktimat e incidenteve të lidhura me armë zjarri në Shqipëri dhe Serbi



VRASJA E GRAVE

Sipas bazës së të dhënave të Sekretariatit të Deklaratës së Gjenevës për 48 vendet për të cilët kishte të dhëna të disponueshme të besueshme për periudhën 2007-2012, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë është e para ndër vendet e Evropës Juglindore dhe që renditet e 12-ta në listën e përgjithshme, me më shumë se 40% të vrasjeve të grave të kryera me armë zjarri, e ndjekur nga Republika e Serbisë që renditet e 17-ta, ndërsa Moldavia renditet në fund të listës e 42-ta. (Sekretariati i Deklaratës së Gjenevës, 2015, 104). Në lidhje me dhunën ndërmjet partnerëve intimë, në Serbi, në vitin 2015, 45,7% e grave viktime të dhunës nga partneri intim janë vrarë me armë zjarri (Mreža “Žene protiv nasilja” 2016). Nuk disponohen të dhëna për shoqëritë në vende të tjera të Evropës Juglindore. Përqindja e lartë e grave të vrara me armë të vogla pasqyron rrezikun e lartë që paraqesin armët e zjarrit për jetën dhe ajo përbën një argument të fortë për kontrollin e tyre, veçanërisht në kontekstin e dhunës në familje.

Si trajtohen çështjet gjinore në kuadrin ligjor dhe atë të politikave për kontrollin e SALW në Evropën Juglindore?



Analizat e kryera nga SEESAC tregojnë se:

1. Pavarësisht dimensioneve të larta gjinore të SALW, këndvështrimi gjinor as nuk trajtohet, as nuk është integruar në politikat që rregullojnë kontrollin e SALW në Evropën Juglindore.
2. Nëse bëhen përpjekje për të trajtuar aspektet ekzistuese gjinore të SALW, ato preken në mënyrë të fragmentuar, kryesisht në fushën e dhunës në familje.
3. Për sa i përket mbajtjes, përdorimit dhe keqpërdorimit të armëve të zjarrit, efekteve të diferencuara të armëve të zjarrit mbi gratë dhe burrat, mekanizmave ku rolet gjinore u japin formë praktikave dominuese të SALW në Evropën Juglindore, diferencat gjinore mbeten të patrajtuara.
4. Mungesa e të dhënave gjinore të ndara ose kërkimeve gjithëpërfshirëse për lidhjet ndërmjet çështjeve gjinore dhe SALW, përbën një faktor pengues për hartimin e politikave për kontrollin e armëve, të cilat u përgjigjen çështjeve gjinore.
5. Janë ndërmarrë disa hapa, edhe pse ende në fazë fillestare, për të përfshirë këndvështrimin gjinor në përgjigjen e politikave për kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta. Për shembull, janë bërë përpjekje të posaçme për të nxitur pjesëmarrjen e grave (grupe të shoqërisë civile) në hartimin dhe zbatimin e politikave ose për të përfshirë mekanizmat e barazisë gjinore në përcaktimin e një kuadri strategjik. Gjithashtu, në projektimin e modelit të studimit janë bërë përpjekje për të marrë në konsideratë ndikimin e diferencuar të armëve të gratë, si dhe për të miratuar masa për të garantuar përfshirjen e ekuilibruar të personelit me gra dhe burra në procesin e trajnimit për menaxhimin e municioneve dhe lëndëve plasëse.

DJEMTË

Djemtë në përgjithësi përfaqësojnë një përqindje të lartë disproporcionale si autorë dhe si viktimave të dhunës që lidhet me armët e zjarrit.

Dhuna që përfshin armët e vogla shihet shpesh nga djemtë e rinj si një mënyrë për të arritur statusin social dhe ekonomik që ata besojnë se meritojnë. Për pasojë, armët e vogla mund të jenë veçanërisht tërheqëse për djemtë duke qenë se ata shpesh i lidhin armët me krenarinë individuale, burrërinë dhe statusin e lartë social. (Bevan and Florquin 2006). Të dhënat e mbledhura në Shqipëri nëpërmjet analizave të medias tregojnë se nga incidentet që lidhen me armët e zjarrit ku autorë vepre janë meshkuj, 55,7% e veprave janë kryer nga meshkuj që i përkasin grupmoshës 19-35 vjeç. Për sa i përket viktimave, burrat e grupmoshës 19-35 vjeç përbëjnë 38,1% të numrit të përgjithshëm të viktimave (SEESAC 2016).



Çfarë fitojmë duke integruar këndvështrimin gjinor?


Integrimi i këndvështrimit gjinor në kontrollin e SALW nuk do të thotë vetëm të numërosh gratë dhe burrat, por do të thotë të përdorësh të dhënat e ndara sipas gjinisë për të identifikuar dhe për të reaguar ndaj rreziqeve specifike gjinore me të cilat përballen gratë dhe burrat në lidhje me SALW. Ky informacion i shton një dimension perceptimit të këtij problemi, i cili shpesh nuk vihet re, por që ka një ndikim të konsiderueshëm në efikasitetin e ndërhyrjeve. Integrimi i çështjeve gjinore në të gjitha ciklet e kontrollit dhe menaxhimit të SALW rrit perceptimin e kompleksitetit të problemit dhe për rrjedhojë mundëson krijimin e politikave më të përshtatshme dhe më efektive për kontrollin e SALW, të përshtatura më mirë me sfidën me të cilën përballemi. Qëllimi përfundimtar është një shoqëri më e sigurt që ofron një siguri të barabartë si për gratë, ashtu edhe për burrat. Kjo mund të arrihet vetëm nëse merren në konsideratë nevojat e ndryshme të grave dhe burrave.



Çfarë tregojnë përvojat nga vendet e tjera?

Reformat legjislativë në lidhje me mbajtjen dhe lejet e armëve, që janë zbatuar në disa vende, si p.sh. Kanada dhe Australi, kanë vërtetuar se ato janë efektive në uljen e nivelit të përgjithshëm të vrasjeve (15% në Kanada dhe 45% në Australi) dhe veçanërisht për nivelin e vrasjes së grave (45% në Kanada dhe 57% në Australi), gjë që vërteton se ka një lidhje të fortë ndërmjet futjes së masave më të rrepta për kontrollin e armëve të zjarrit dhe uljes së rrezikut përfundimtar në rastet e dhunës mes partnerëve intimë. Legjislativët e miratuar në Afrikën e Jugut për kontrollin e armëve dhe kundër dhunës në familje, ka kontribuar në uljen e nivelit të vrasjes së grave nga 8,8 në vitin 1999 në 5,6 në vitin 2009 (Amnesty International, Rrjeti Ndërkombëtar i Veprimt për Armët e Vogla (IANSA) dhe Oxfam International, 2005).

Raportet për politikat që kanë si objektiv djemtë e rinj në SHBA japin prova që tregojnë se programet specifike dhe proaktive, të shoqëruara me programe të ndërhyrjes në sjellje kanë qenë efikase në uljen e dhunës me armë ndërmjet djemve të rinj (Abt and Winship, 2016).



Hapat e mëtejshëm: Si të integrohet këndvështrimi gjinor në kuadrin ligjor dhe të politikave për kontrollin e SALW?

Për të garantuar që kuadrot e ndryshme për kontrollin e SALW t'i përgjigjen aspektit gjinor, këndvështrimi gjinor duhet të depërtojë në të gjithë ciklin e kontrollit dhe menaxhimit të SALW, ku përfshihet: projektimi, zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi. Marrja e hapave konkretë të mëposhtëm lehtëson shndërrimin e angazhimeve për barazi gjinore në masa praktike:

Hapi 1: Garantimi i konsensusit për rëndësinë që ka aspekti gjinor në kontrollin e SALW. Mirëkuptimi i përbashkët për rolin që luan aspekti gjinor në formësimin e sjelljeve që lidhen me SALW, të praktikave dhe rrezikut specifik për gratë dhe burrat është kushti paraprak bazë për integrimin efikas dhe të qëndrueshëm të këndvështrimit gjinor në kuadrin për kontrollin e SALW. Për rrjedhojë, është e nevojshme që të garantohet se të gjithë aktorët e përfshirë ndajnë të njëjtat njohuri ose kanë marrë trajnime për barazinë gjinore, integrimin gjinor, analizat gjinore dhe lidhjet ndërmjet gjinisë

dhe SALW. Përfaqësimi i ekuilibruar i grave dhe burrave në aktorët e përfshirë është një pjesë thelbësore e integritetit të këndvështrimit gjinor në kontrollin e SALW, ndërsa përfshirja e organizatave të grave dhe ekspertëve gjinorë në këtë çështje është e nevojshme për të lehtësuar procesin.

Hapi 2: Vizibiliteti i këndvështrimit gjinor - mbledhja e të dhënave të ndara sipas gjinisë. Të dhënat e ndara sipas gjinisë janë një kusht paraprak për të kuptuar lidhjet ndërmjet çështjeve gjinore dhe SALW dhe për të hartuar politika reaguese ndaj çështjeve gjinore, të mbështetura në fakte. Për rrjedhojë, të gjitha të dhënat për viktimat dhe autorët e incidenteve me armë zjarri, për zotëruesit e armëve të zjarrit, për personat që kanë leje për të mbajtur armë zjarri dhe të dhënat e tjera përkatëse duhet të ndahen përkatësisht sipas gjinisë. Për të trajtuar plotësisht aspektet gjinore të SALW, është gjithashtu e nevojshme që të kuptohet sesi ndërthuret gjinia me karakteristikat e tjera demografike, si p.sh. mosha, raca, etnia, vendbanimi (urban/rural) etj.

Hapi 3: Identifikimi i modeleve dhe shqetësimeve gjinore - Kryerja e analizës gjinore. Të përfshihen këto të dhëna në analizën e situatës, duke siguruar se përfundimet bazohen te kjo analizë. Të eksplorohet sesi ndryshimet gjinore lidhen me çështjet e kontrollit të SALW dhe të identifikohen dhe përcaktohen rreziqet dhe sfidat specifike që lidhen me gjininë. Një paketë e gjerë me metoda praktike, si manuale, lista kontrolli dhe udhëzime për analizën gjinore është zhvilluar dhe mund të gjendet lehtësisht.

Hapi 4: Trajtimi i modeleve të identifikuara gjinore - Përcaktimi i objektivave dhe treguesve që i përgjigjen aspektit gjinor dhe përcaktimi i masave praktike dhe novatore që bazohen në të dhënat e ndara sipas gjinisë, për të trajtuar siç duhet aspektet gjinore të SALW. Projektimi i veprimtarive që përmbushin nevojat e sigurisë si për gratë, ashtu edhe për burrat, dhe trajtimi i rreziqeve me të cilët ata përballen.

Hapi 5: Gjurmimi i progresit - Monitorimi dhe vlerësimi. Sigurimi se plani i monitorimit mbulon plotësisht zbatimin e masave të përcaktuara për të trajtuar shqetësimet gjinore të identifikuara. Një vlerësim duhet të përcaktojë nëse janë trajtuar/ulur rreziqet specifike gjinore për gratë dhe për burrat, si dhe të japë rekomandime të qarta për veprimet e mëtejshme.

Referencat:

Abt, Thomas and Winship, Christopher. 2016. What Works in Reducing Community Violence: A Meta-Review and Field Study for the Northern Triangle. United States Agency for International Development.

Alvazzi del Frate, Anna. 2011. When the Victim Is a Woman. In Geneva Declaration Secretariat. Global Burden of Armed Violence: Lethal Encounters. Cambridge: Cambridge University Press.

Amnesty International, the International Action Network on Small Arms (IANSA) and Oxfam International. 2005. The Impact of Guns on Women's Lives. Oxford: The Alden Press.

Bastick, Megan and Valasek Kristin. 2014. "Converging Agendas: Women, peace, security, and small arms" in Small Arms Survey 2014: Women and Guns. Cambridge: Cambridge University Press.

Bevan, James and Nicholas Florquin. 2006. Few options but the gun: Angry young men. Small Arms Survey. Unfinished Business. Geneva: Small Arms Survey.

Cukier, Wendy and James Cairns. 2009. Gender, attitudes and the regulation of small arms: Implications for action. In Farr, Vanessa, Henri Myrntinen and Albrecht Schnabe (eds.). 2009. Sexed Pistols: The Gendered Impacts of Small Arms and Light Weapons. Tokyo: United Nations University Press.

Cukier, Wendy and Alison Kooistra and Mark Anto. 2002. Gendered Perspectives on Small Arms Proliferation and Misuse. In Farr, Vanessa A. and Kiflemariam Gebre-Wold (eds.). 2002. Gender Perspectives on Small Arms and Light Weapons: Regional and International Concerns. Bonn: Bonn International Centre for Conversion.

Farr, Vanessa A. and Kiflemariam Gebre-Wold (eds.). 2002. Gender Perspectives on Small Arms and Light Weapons: Regional and International Concerns. Bonn: Bonn International Centre for Conversion.

Geneva Declaration Secretariat, 2015, Global Burden of Armed Violence 2015: Every Body Counts. Cambridge: Cambridge University Press.

Mreža "Žene protiv nasilja". 2016. FEMICID - UBISTVA ŽENA U SRBIJI Kvantitativno - narativni izveštaj 2015. godina. Beograd http://www.zeneprotivnasilja.net/images/pdf/FEMICID-Kvantitativno-narativni_izvestaj_za_2015_godinu.pdf.

Office of the Special Advisor on Gender Issues and Advancement of Women. 2001. Gender Mainstreaming: Strategy for Promoting Gender Equality. Available: URL: <http://www.un.org/womenwatch/osagi/pdf/factsheet1.pdf>, Date accessed [7 September 2016].

SAS (Small Arms Survey). 2014a. Small Arms Survey: Women and Guns. Cambridge: Cambridge University Press.

SAS (Small Arms Survey). 2014b. Women and Gun Ownership. Geneva: Small Arms Survey.

SEESAC. 2006. The Rifle has the Devil Inside – Gun Culture in South Eastern Europe. Belgrade: SEESAC.

SEESAC. 2015. Oružje na meti: Zloupotreba vatrenog oružja u Srbiji. Belgrade: SEESAC.

SEESAC. 2016. Armët në Shënjestër (unpublished).

Schroeder Emily, Vanessa Farr and Albrecht Schnabel. 2005. Gender Awareness in Research on Small Arms and Light Weapons: A Preliminary Report. Bern: Swisspeace.

SEESAC është duke zbatuar **VENDIMIN E KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN 2013/730/CFSP**, në mbështetje të aktiviteteve të SEESAC për çarmatimin dhe kontrollin e armëve në Evropën Juglindore - projekti EUSAC. Bashkimi Evropian e ka mbështetur SEESAC që prej vitit 2002 dhe projekti EUSAC është pjesë e portofolit të SEESAC për kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta (SALW).

Për të mësuar më shumë, jeni të lutur të vizitoni faqen e internetit www.seesac.org

Ky raport është shkruar nga Dragan Bozanić. Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë të vetë autorit dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal apo të Bashkimit Evropian. Emërtimet e përdorura dhe prezantimi i materialit në këtë botim nuk nënkuptojnë shprehjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal apo të Bashkimit Evropian për 1) statusin ligjor të një shteti, territori ose zone, apo për autoritetet ose grupet e armatosura të tij; ose 2) për vijëzimin e kufijve të tij.



This project is funded by
the European Union



Empowered lives. Resilient nations.



UNDP SEESAC

Bulevar Zorana Đinđića 64, 11070 Belgrade / SERBIA

Telephone: +381 (11) 4155 300

Fax: +381 (11) 4155 499

E-mail: seesac@undp.org

www.seesac@undp.org